



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:200096

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06901952

C.nr.3831/2024

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit S.S. nga fshati Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. P.K. nga Gjakova, kundër të paditurit L.S. nga fshati Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson, av. R.H. nga Rahoveci, përmes Zyrës për Ndihmë Juridike Falas në Gjakovë, për shkak të pengim posedimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në prezencë të të të paditurit si dhe të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datë 11.02.2025, mori ndërsa me datë 26.02.2025, përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.S.u nga fshati Komuna e Rahovecit.

II. VËRTETOHET se i padituri L.S. nga fshati Komuna e Rahovecit, e ka penguar paditësin, në posedimin e fundit të lirë faktik, në atë mënyrë që me datë 29.06.2024, pa pëlqimin e paditësit, i padituri ia ka lëvruar me traktor pjesën e pronës të mbjellë me misër në sipërfaqe prej 596 m², në vendin e quajtur Slogovi-Basarina, e cila është pjesë përbërëse e ngastrës kadastrale ZK Krushë e Vogël, e cila në lindje kufizohet me parcelën nr. në anën lindore dhe jugore pjesën e parcelës 2080-0 që është e mbjellë me misër në sipërfaqe prej 3462 m², në anën veri perëndimore me pjesën e parcelës 2080-0, që është ara e lëvruar në sipërfaqe 443 m².

III. DETYROHET i padituri, që të mos e pengojë paditësin në të ardhmen në shfrytëzimin në mënyrë të qetë dhe të përmbahet nga çfarëdo shqetësimi ndaj paditësit në posedim të pjesës së paluajtshmërisë të cekur si në pikën II të këtij dispozitivi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

IV. DETYROHET i padituri, që në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguaj paditësit, shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,029.00 €, dhe atë në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi S.S. nga fshati Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit të tij av.P.K. nga Gjakova, pranë kësaj gjykate me dt.15.07.2024, ka parashtruar padi ndaj të paditurit L.S. nga fshati Komuna e Rahovecit, për shkak të pengim posedimit.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se, paditësi dhe i padituri janë vëllezër, të njëjtit këtë tokë e kanë trashëgimi nga babai i tyre, e cila gjendet në fshatin Krushë e Vogël, komuna e Rahovecit, me numër P-71813053-..... në sipërfaqe prej 8180 m², ZK Prizren, ku paditësit pas ndarjes i takojnë 28 ari ndërsa të paditurit 12 ari, të cilët në mënyrë faktike janë duke e shfrytëzuar që disa vite, ndërsa në regjistrat kadastral është evidentuar në emër të djalit të agjes H.S. Paditësi paluajtshmërinë lëndore e ka pasur në shfrytëzim dhe posedim të qetë duke e punuar deri me dt.29.06.2024, ku i padituri ka shkuar tek parcela lëndore e ka kryer aktin e pengim posedimit duke e penguar këtu paditësin që të punoj-lëvroj tokën. Paditësi ka kërkuar nga i padituri që me vullnetin e tij të mos e pengoj paditësin që të punojë tokën e tij ashtu qysh ka qenë duke punuar deri më tani. Kështu që i padituri e veprimin e vet e ka shqetësuar paditësin që ta posedoi dhe shfrytëzoi paluajtshmërinë e lartë cekur në mënyrë të qetë dhe pa pengesa ashtu që përmes kësaj padie kërkon që të i ofrohet ndihmë gjyqësore nga ana e gjykatës. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, me petitum si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri në përgjigje në padi ka theksuar se, e kundërshton në tërësi padinë e paditësit si të pa rregullt dhe të pathemeltë nga fakti se i padituri është në posedim dhe shfrytëzim të qetë dhe të pa penguar të paluajtshmërisë lëndore që nga viti 2008 e tutje deri në ditën e sotme. Nisur nga kjo që u citua pas shqyrtimit dhe nisur nga parashtrimet e paraqitura në përgjigje në padi, gjykatës i propozojmë që pas administrimit të provave relevante të hedh poshtë padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar.

I autorizuari i paditësit në seancat e mbajtura si dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar, se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe precizimit të kërkesëpadisë të datës 11.02.2025, ka shtuar se paditësi paluajtshmërinë kontestuese e ka të trashëguar nga pasardhësit të cilën e ka në shfrytëzim dhe posedim të qetë deri më datë 29.06.2024, kur i padituri me veprimet e tij e ka ndërprerë paditësin duke mos e lejuar ta shfrytëzojë në pjesën e tij prej sipërfaqe prej 28 ari e cila është pjesë përbërëse e pronës me njësi kadastrale ZK Prizren. Paditësi ka kërkuar nga i padituri që mos ta pengoj mirëpo i padituri ka vazhduar edhe më tutje duke penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë të pronës. Pas administrimit të provave materiale, dëgjimit të dëshmitarëve dhe dëgjimit të palëve ndërgjyqëse u vërtetua në tërësi se i padituri me datë 29.06.2024, ka kryer aktin e pengim posedimit në sipërfaqe prej 596 m², të cilën sipërfaqe paditësi e kishte në posedimin e fundit faktik, e kishte të mbjellë me misër ndërsa i padituri në mënyrë arbitrare dhe pa pëlqimin e paditësit e lëvronte sipërfaqen me traktor duke e prishur misrin dhe duke penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë dhe të lirë të kësaj pjese të pronës. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit të precizuar me datë 11.02.2025, gjithashtu të detyrojë të paditurin që paditësit t'i paguaj shpenzimet procedurale për 5 seanca të mbajtura nga 135.00 euro, shumën prej 675.00 euro, për taksë në padi shumën prej 50.00 euro, për shpenzimet e ekspertit të gjeodezisë shumën prej 200.00 euro, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, e në shumë të përgjithshme shumën prej 1,029. euro.

I autorizuari i të paditurit në seancat e mbajtura si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi me të cilën e kemi kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Pas administrimit të provave është vërtetuar se i padituri L.S. nuk ka kryer aktin e pengim posedimit posaçërisht kjo është vërtetuar me daljen e

gjykatës në vendin e ngjarjes bashkë me gjeodet ku në vend nuk është vërejtur se i njëjti ka kryer aktin e pengim posedimit. I padituri vazhdimisht e ka punuar edhe parcelën në të cilën pretendohet se është kryer akti i pengim posedimit e po ashtu është vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarit R.S. i cili ka deklaruar se i padituri L.S. në tërësi e ka punuar parcelën kadastrale me numër ZK Krushë e Vogël dhe askush nuk e ka penguar që ta punojë pasi që kultura bujqësore vazhdimisht i ka mbjellë dhe korrur i padituri L.S. pasi që paditësi S.S. gjendet jashtë vendit ndërsa i padituri L.S. jeton në Krushë të Madhe dhe çdo veprim që është ndërmarrë në këtë parcelë nga i padituri L. është ndërmarrë me pëlqimin e paditësit dhe në këtë çështje kontestimore nuk kemi pengim posedim andaj, gjykatës i propozoj që të bie vendim dhe ta refuzojë padinë gjegjësisht precizimin e kërkesëpadisë të dorëzuar sot në këtë gjykatë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë sipas listës të zyrës për ndihmë juridike falas për pesë seanca, apo shumën e përgjithshme prej 500.00 euro.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: ekspertizën e gjeodezisë e datës 13.11.2024, punuar nga eksperti i gjeodezisë B.M. nga Gjakova; plotësimin e ekspertizës së gjeodezisë të datës 13.11.2024, punuar nga eksperti i gjeodezisë B.M. me datë 22.12.2024; dëgjimin e paditësit S.S. dëgjimin e të paditurit L.S. dëgjimin e dëshmitarit M.S. dëgjimin e dëshmitarit R.S. certifikatën e pronësisë lidhur me ngastrën kadastrale ZK Krushë e Vogël e datës 06.07.2023; shikimin e një fotografie pjesë e shkresave të lëndës.

Nga leximi i ekspertizës së gjeodezisë të datës 13.11.20024, punuar nga eksperti i gjeodezisë B.M. nga Gjakova, gjykata ka vërtetuar se, i njëjti pas daljes në teren së bashku me gjykatën dhe palët ka bërë identifikimin dhe matjen e gjendjes faktike në ngastrën kadastrale P-71813053-..... në sipërfaqe prej 8180 m², ku në anën veri-lindore është e punuar-lëvruar ara dhe është matur me GPS ku nga koordinatat në sistemin KOPOS derivon sipërfaqja S=405 m², kurse pjesa tjetër e parcelës është e mbjellë me misër duke filluar nga ana veri-lindore dhe jugore e cila është në sipërfaqe S=3417 m², si dhe pjesa e lirë e parcelës e pa mbjellë në anën veriore e cila është në sipërfaqe prej S=84 m².

Nga leximi i plotësimit të ekspertizës së gjeodezisë të datës 13.11.2024, punuar nga eksperti i gjeodezisë B.M. me datë 22.12.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se parcela 02080-0 në anën veri-lindore kufizohet me parcelat nr.2752-3 dhe 2752-5 (...), ku janë të vendosura baraka montazh dhe pjesa tjetër lulishte. Në anën lindore dhe jugore pjesë e parcelës 2080-0 është e mbjellë me misër në sipërfaqe 3462 m², dhe ana veri perëndimore e pjesës të parcelës 2080-0 është ara e lëvruar në sipërfaqe 443 m², ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 2082-0 është 3905 m². 0

Gjykata konform nenit 362.1 të LPK-së, ka ftuar ekspertin e gjeodezisë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.12.2024 dhe 30.12.2024, i cili ka deklaruar se qëndron pranë ekspertizës së gjeodezisë të datës 13.11.2024, ka shtuar se, Sipërfaqja në të cilën pretendohet se është bërë akti i pengim posedimit, e cila në ekspertizë është cek si pjesë e mbjellë me misër ku theksohet sipërfaqja prej 2866 m², është në sipërfaqe prej 551 m². Sipërfaqja prej 84 m² është tokë e papunuar, e cila është pjesë e sipërfaqes prej 551 m². Sa i përket plotësimit të ekspertizës ka theksuar se plotësimi është bërë për shkak të vërejtjeve në sipërfaqe ku ka qenë si tokë e pa punuar në sipërfaqe prej 84 m², në plotësimin e ekspertizës të datës 22.12.2024, e ka plotësuar sipas vërejtjeve, ashtu që ngastra si arë me misër është plotësuar në sipërfaqen 84 m², ku kjo

sipërfaqe tani rezulton të jetë prej 596 m², ndërsa ana e lëvruar me plotësimin nga sipërfaqja 84 m² rezulton të jetë 443 m², ku në sipërfaqe të përgjithshme mbetet 3905 m².

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.12.2024, ka bërë dëgjimin e paditësit S.S. në cilësi të palës i cili ka deklaruar se, me të paditurin është në gjini gjaku, përkatësisht të njëjtin e ka vëlla. Sipërfaqen e vëllait R. e kam blerë unë dhe aktualisht e shfrytëzojmë unë dhe L. pra unë e shfrytëzojë një pjesë të sipërfaqes më shumë se L. sipërfaqen që e kam blerë nga R. diku rreth 28 ari apo 30, por saktësisht nuk e di sepse nuk më ka interesuar dhe nuk kemi bërë ndarje asnjëherë, por që nga koha kur jemi ndarë ja kam blerë R. pjesën e tij, dhe kështu e kemi pasur të rregulluar shfrytëzimin. Pjesa e mbjellë me misër është e imja, unë e shfrytëzojë, atë e kultivojë unë përkatësisht në verën e këtij viti e kam mbjellë me misër dhe këtë sipërfaqe e shfrytëzojë që nga kur jemi ndarë dhe na ka lënë babai ynë. Që nga viti 2016 e deri në vitin 2023, përkatësisht të muajit qershor këtë sipërfaqe e kemi shfrytëzuar bashkërisht, ku në këtë kohë jemi ndarë dhe kemi çrregulluar raportet. Sipërfaqen kontestuese e cila ka qenë e mbjellë më parë me detelinë, e ka punuar djali im me L. I padituri e ka lëvruar sipërfaqen e mbjellë me misër, pra e kam parë personalisht duke e bërë lëvrimin e kësaj are diku në muajin korrik, por misri ka bi përsëri mirëpo më rrallë. Akti i pengimit është bërë në pjesën e kanalit që është mbjellë me misër. Pas kësaj nuk kam pasur pengesë, pasi që kam shkuar në Zvicër dhe më nuk kam pasur informacion.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.12.2024, ka bërë dëgjimin e të paditurit L.S. në cilësi të palës i cili ka deklaruar se, me paditësin është në gjini gjaku, përkatësisht të njëjtin e ka vëlla. Nga viti 2008 kur jemi ndarë tre vëllezërit me short, poshtë nga pjesa e Drinit te rruga i ka ra vëllait të madh R. 13 ari e pak, po ashtu edhe vëllai tjetër S. i ka ra aq, ndërsa mua më ka rënë te kanali në hyrje. Pjesa ku pretendohet se është bërë pengim posedimi, i bie nga rruga kryesore e cila është e imja, e cila në muajin qershor korrik është mbjellë me misër nga ana e S. e cila ka qenë e mbjellë me janxhë nga unë dhe është lëvruar nga paditësi e pastaj është mbjellë misër, duke pasur parasysh se unë mendoj se është pjesa ime, të njëjtën e kam lëvruar edhe pse ka qenë e mbjellë me misër nga S. pasi që deri në qershor të vitit 2023, pjesën e mbjellë me misër dhe atë me janxhë e kam punuar dhe shfrytëzuar unë. Janxha është lëvruar nga paditësi para dy viteve, ndërsa vitin e fundit pra në qershor të vitit 2024 e kam mbjellë me misër. Para dy viteve kur për herë të parë e ka lëvruar S. sipërfaqen kontestuese, e kam njoftuar policinë dhe të njëjtit kanë përpiluar raport ku i kanë dhënë të drejtë S.për të mbjellë, një periudhë personi H.S. e ka lëvruar dhe frezatur ndërsa S. ka pasur të drejtë ta shpërndajë farën në emrin tim por nuk e ka bërë, ndërsa në vitin 2024, përkatësisht në qershor të këtij viti e ka mbjellë me misër.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.12.2024, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit M.S.i cili ka deklaruar se, me palët ndërgjyqëse është në lidhje farefisnore, përkatësisht paditësin e ka baba dhe të paditurin e ka axh. Sipërfaqen kontestuese e shfrytëzon në tërësi familja e S.S. e cila gjendet në magjistralën Prizren-Gjakovë, diku rreth 31 ari, por me sa e di unë edhe L. e shfrytëzon një pjesë të vogël. Pjesën me misër e kemi mbjellë ne familja S. dhe të njëjtën e shfrytëzojmë një kohë të gjatë. L. në mënyrë të fshehtë e ka lëvruar arën, këtë informatë e kam kuptuar pasi që personalisht e kam parë duke e kryer këtë veprim, i cili veprim ka ndodhur gjatë këtij viti. Kjo pjesë e lëvruar ndodhet në hyrje të ngastrës nga rruga kryesore, nga ana e majtë e saj, ndërsa pjesa nga ana e djathtë është e pa mbjellë me misër dhe e lëvruar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.12.2024, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit R.S. i cili ka deklaruar se, me palët ndërgjyqëse është në lidhje farefisnore, përkatësisht paditësin dhe të paditurin i ka vëllezër. Pjesën e parcelës kadastrale 2080-0, deri në vitin 2023 e

ka shfrytëzuar L.S., nga viti 2023 në muajin qershor-korrik, L. e ka hasur djalën e paditësit M. dhe H.S. duke e lëvruar pjesën kontestuese dhe e ka lajmëruar policinë, kanë ardhur policia, kanë bërë raport dhe i kanë thënë se H. do ta lëvrojë, do ta frizit dhe do ta mbjellë detelinë, përkatësisht S. do ta mbjellë, të gjitha këto i kam të dëgjua dhe thëna nga ana e L. dhe nga H.S.... S. ka pasur të mbjellë këtë sipërfaqe për L. pasi që i njëjti e punon që 17-18 vite, nga viti 2008, nga viti 2016 unë ja kam shitur pjesën time S. ku e njëjta ka qenë afër Drinit, në mes ka qenë pjesa e S. ndërsa në fund afër asfaltit-rrugës kryesore ka qenë e L. pra pjesët kanë qenë të ndara në pjesë horizontale nga Drini deri në rrugën kryesore, të gjitha këto informata i di sepse edhe unë kam qenë pjesë e ndarjes nga viti 2008 dhe ka qenë propozim i imi që ngastra të ndahet në këtë mënyrë dhe të gjithë jemi pajtuar. S. dhe L. kanë hyrë nga pjesa ime dhe kanë kaluar në pjesët e tyre dhe në këtë mënyrë e kanë shfrytëzuar dhe punuar. Kam informata që S. e ka lëvruar pjesën që ka qenë e mbjellë me detelinë nga L. dhe S. të njëjtën e ka mbjellë me misër, në mes apo fund të qershorit të vitit 2024.

Nga leximi i certifikatës së pronësisë lidhur me ngastrën kadastrale ZK Krushë e Vogël e datës 06.07.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo ngastrë është e evidentuar në emër të H.S.

Nga shikimi e një fotografie pjesë e shkresave të lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se pjesa e parcelës objekt i këtij kontesti shihet të jetë e kultivuar.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të tjera të theksuara më lartë, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ku ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Baza Ligjore

Me nenin 113 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (LPDTS), është paraparë se *“nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta”* ndërsa në par. 2 të këtij neni ceket se *“nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*. Në nenin 114 të këtij ligji, është paraparë se *“Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijëni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit”*. Në lidhje me këtë çështje juridike, gjykata duke u bazuar në nenin 480 të LPK-së, është kufizuar vetëm në *konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit.*

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, është provuar fakti se paditësi është duke u penguar nga ana e të paditurit në posedimin e lirë dhe të fundit faktik të

paluajtshmërisë të cekur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Në këtë përfundim gjykata ka ardhur duke u bazuar në provat e lartë administruara. Në këtë drejtim, gjykata ka vlerësuar pretendimet se i padituri me rastin e lëvrimit të një pjese të paluajtshmërisë, të cilën paditësi e ka mbjellë me misër, ka kryer aktin e pengim posedimit dhe se paditësi është penguar në posedimin e paluajtshmërisë. Kështu, për të vërtetuar nëse veprimet e të paditurit e kanë penguar paditësin në posedimin e fundit gjykata u orientua në vërtetimin e fakteve si në vijim, kush e ka pasur posedimin e fundit, cili është veprimi i pengimit dhe kur është ndërmarrë ky veprim. Nga të gjitha provat e administruara, vlerësimi të fakteve në këtë procedurë gjykata erdhi në përfundim se i padituri me veprimet e ndërmarra (lëvrimin e një pjese të paluajtshmërisë të mbjellë me misër), e ka penguar paditësin në posedimin e sendit, përkatësisht pjesës së paluajtshmërisë të cilën e ka mbjellë me misër, duke ia dëmtuar kështu edhe të mbjellat.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të faktit lidhur me poseduesin e fundit faktik të sendit- pjesës së paluajtshmërisë kontestuese, ka bërë dëgjimin e palëve ndërgjyqëse, ku vet i padituri gjatë deklaramit të tij e ka pohuar faktin se e ka lëvruar një pjesë të mbjellë me misër nga ana e paditësit, nën supozimin se ajo pjesë është e tij. Për gjykatën një aprovim i tillë i të paditurit është i mjaftueshëm për të vërtetuar se cili nga palët ndërgjyqëse e ka pasur në posedim të fundit paluajtshmerinë. Gjithashtu i autorizuari i të paditurit në seancë ka deklaruar se dhe “çdo veprim që është ndërmarrë në këtë parcelë nga i padituri L. është ndërmarrë me pëlqimin e paditësit dhe në këtë çështje kontestimore nuk kemi pengim posedim”, pra ka pohuar se paditësi ka qenë në posedim të kësaj pjese të paluajtshmërisë. Me posedim kuptojmë pushtetin faktik mbi sendin, në rastin konkret pushteti faktik mbi sendin e paluajtshëm- ngastrën kadastrale, do të realizohet duke mbjellë tokën, ndërtuar mbi të, etj. (posedimi direkt), apo duke e lëshuar me qira, duke e dhënë peng, depozitë, marrëveshje ose raporte juridike të ngjashme që i japin personit tjetër të drejtën e posedimit të sendit për kohë të caktuar (posedimi i tërthortë), e që në rastin konkret paditësi shfrytëzimin e sendit e ka manifestuar duke e mbjell me misër. Gjykata vlerëson se veprimet e lartpërmendura të të paditurit, përbëjnë veprime përmes të cilave paditësi është penguar në shfrytëzimin e lirë të sendit të cilin e ka pasur në posedim, kjo për faktin se pasi që paditësi e ka mbjellë një pjesë të ngastrës kadastrale nr. me misër, i padituri e ka lëvruar një pjesë të asaj pjese me të mbjella, e që pengim posedim ekziston në rastet kur poseduesi pengohet në posedimin e sendit, që në rastin konkret në kohën kur i padituri ka ndërmarrë veprimet (lëvrimin e një pjese të paluajtshmërisë) paditësi ka qenë në posedim të së njëjtës, fakt ky i vërtetuar nga provat e theksuara më lartë, konkretisht nga deklarimi i paditësit, dëshmitarit M.S. e mbi të gjitha nga vet deklarimi i të paditurit.

Sa i përket deklaramit të dëshmitarit R.S në cilësi të dëshmitarit, gjykata nuk ia fali besimin për shkak se gjatë deklaramit të tij ka konfirmuar se këto informata të deklaruara i ka të ditura nga ana e të paditurit L.S. e që lidhur me çështjen për vërtetimin e gjendjes faktike nuk ka pasur asnjë ndikim relevant. Gjykata nuk i fali besimin një pjese të ekspertizës të datës 13.11.2024, të punuar nga eksperti gjeodet në të cilën i njëjti ka konstatuar se sipërfaqen prej 405 m² e shfrytëzon L.S., kurse pjesën tjetër të parcelës të mbjellë me misër në sipërfaqe prej 3417 m² e shfrytëzon S.S. kjo për faktin se detyrat e ekspertit kanë qenë konstatimi i gjendjes faktike në teren sa i përket identifikimit të ngastrës kadastrale, respektivisht të pjesës së ngastrës kadastrale, ashtu që i njëjti nuk është i thirrur të konstatoj se kush është në shfrytëzim të paluajtshmërisë, andaj një konstatimi të tillë gjykata nuk ia fali besimin për shkak se është dhënë jashtë autorizimeve që ka eksperti. Gjithashtu deklarimin e të paditurit se i njëjti e ka pasur të mbjellë me detelinë të njëjtën paluajtshmeri dhe se paditësi e ka lëvruar këtë paluajtshmeri e pastaj e ka mbjellë me misër, gjykata e vlerësoi të pabazuar këtë pretendim, më saktësisht si tërësisht jo relevant për faktin se vet i padituri ka deklaruar se këto veprime janë

ndërmarrë para 2 viteve dhe se gjykata në çështjen e pengim posedimit orientohet në mënyrë specifike sa i përket posedimit të fundit dhe pengimit të bërë. Andaj, sikurse është theksuar më lartë, gjykata në këtë procedurë është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të këtij pushteti në mënyrë të kundërligjshme dhe të padrejtë, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit apo ndonjë të drejtë tjetër sendore, e të cilat eventualisht do të ishin objekt kontesti në ndonjë procedurë tjetër, por që nuk mund të gëzojë mbrojtje ligjore sipas dispozitave të pengim posedimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par. 1 të LPK-së, duke e obliguar të paditurin t'ia kompensoj shpenzimet procedurale paditësit, dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, për taksë gjyqësore shumë prej 50.00 euro, për shpenzimet e ekspertit shumë prej 200.00 euro, si dhe për përfaqësuesin e autorizuar me nga 135.00 euro në çdo seancë, gjithsej 5 seanca, e në shumë prej 1,029.00 euro.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 142 par. 3 dhe nenin 480 të LPK-së lidhur me nenin 113 të LPDTS-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3831/2024, datë 11.02.2025

Gjyqtari
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.